



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 160

Tiranë – E hënë, 6 nëntor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 45, datë 3.10.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-419, datë 15.6.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimin e nenit 435, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në pjesën që parashikon detyrimin për nënshkrimin e aktit të rekursit nga mbrojtësi dhe cilësimin juridik të subjektit si “i pandehur” dhe jo “i dënuar”.....	17023
Vendim i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nr. 13, datë 31.10.2023	Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.....	17031
Vendim i Enti Rregullator të Energjisë nr. 287, datë 9.10.2023	Mbi propozimin për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX dhe miratimin e listës së tarifave....	17032
Vendim i Enti Rregullator të Energjisë nr. 288, datë 9.10.2023	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	17042
Vendim i Enti Rregullator të Energjisë nr. 289, datë 9.10.2023	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	17043
Vendim i Enti Rregullator të Energjisë nr. 290, datë 9.10.2023	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kw.....	17044
Vendim i Enti Rregullator të Energjisë nr. 291, datë 9.10.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 16.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kamëçan’, me kapacitet të instaluar 1860 kw”, i ndryshuar.....	17045



VENDIM

Nr. 45, datë 3.10.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 3.10.2023
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 6 (I) 2022 të Regjistrat
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ilir Muzhaqi

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-
419, datë 15.6.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së
Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e
Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i nenit 435, pika 2, të Kodit të
Procedurës Penale, si i papajtueshëm me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në pjesën
që parashikon detyrimin për nënshkrimin e aktit të
rekursit nga mbrojtësi dhe cilësimin juridik të
subjektit si “i pandehur” dhe jo “i dënuar”.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1,
shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e
vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për
organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, mori
në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, që ka kërkuar
pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të
interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme që,
gjithashtu, ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe
diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Krujë ka regjistruar procedimin penal nr. 142 të vitit
2013 në ngarkim të kërkuarit dhe shoqërisë “Sig-
Ship” sh.p.k., me administrator dhe ortak të vetëm
kërkuarin, për kryerjen e veprave penale “Kallëzimi
i rremë” dhe “Mashtrimi”, të parashikuara nga nenet
305 dhe 143/2 të Kodit Penal (KP).

2. Me vendimin nr. 90, datë 27.4.2015, Gjykata e
Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur deklarimin
fajtor të kërkuarit për akuzat penale, si dhe dënimin
e tij respektivisht me 6 muaj dhe 3 vjet burgim. Në
bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të KP-së,
gjykata e ka dënuar kërkuarin përfundimisht me 3
vjet burgim.

3. Me vendimin nr. 11/299 akti, datë 28.6.2016,
të dhënë në mungesë të kërkuarit dhe në prani të
mbrojtësit të caktuar kryesisht, Gjykata e Rrethit
Gjyqësor Krujë ka vendosur pranimin e kërkesës së
kërkuarit për rivendosjen në afat të së drejtës së
ankimit. Në vijim, kërkuari ka ushtruar ankim
kundër vendimit nr. 90, datë 27.4.2015, të Gjykatës
së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke kërkuar prishjen e
tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë
gjykatë.

4. Me vendimin nr. 811, datë 24.5.2017, Gjykata
e Apelit Tiranë ka vendosur mospranimin e ankimit,
me arsyetimin se kërkuari është rivendosur në afat
në datën 28.6.2016, ndërsa ankimin e ka paraqitur në
datën 8.8.2016, pra jashtë afatit ligjor 10-ditor të
parashikuar në nenin 415 të Kodit të Procedurës
Penale (KPP).

5. Në datën 28.6.2017 kërkuari i është drejtuar
Gjykatës së Lartë me rekurs, duke kërkuar prishjen
e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin
e çështjes për shqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër
trup gjykues. Me shkresën nr. 842 prot., datë
14.7.2017 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, dosja
gjyqësore i është kthyer pa veprim Gjykatës së
Rrethit Gjyqësor Krujë, për shkak të
mosnënshkrimit të rekursit nga avokati, sipas nenit
435, pika 2, të KPP-së. Kërkuari është njoftuar për
këtë me shkresën nr. 30, datë 21.7.2017, të Gjykatës
së Rrethit Gjyqësor Krujë. Në datën 27.7.2017, në
funksion të plotësimit të së metës së evidentuar të
rekursit, kërkuari ka depozituar në Gjykatën e



Rrethit Gjyqësor Krujë një akt me shkrim, protokolluar në datën 1.8.2017, në të cilin ka parashtruar se mbrojtjen e ka realizuar vetë dhe rekursin e ka paraqitur të nënshkruar, ndërkohë që Gjykata e Lartë në bazë të nenit 435, pika 2, të KPP-së, në kushtet kur i pandehuri nuk mund të paraqitej vetë përpara saj, kishte detyrimin të caktonte për të një mbrojtës kryesisht. Po kështu, në datën 2.8.2017, ai i është drejtuar edhe Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar sigurimin e një mbrojtësi për nënshkrimin e rekursit, kërkesë e cila është regjistruar në këtë ministri në datën 16.8.2017 me nr. I-23/8 prot. dhe me shkresën nr. I-23/9, datë 5.9.2017 të saj i është përcjellë për veprim Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike (KSHNJ). Me vendimin nr. 782, datë 25.9.2017, të KSHNJ-së, për dhënien e ndihmës juridike ndaj kërkuarit, në formën e përfaqësimit në çështjen penale me objekt “Rekurs penal ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë”, është caktuar avokati G.R.

6. Në përgjigje të një kërkesë të kërkuarit, me shkresën nr. 4176/1 prot., datë 30.10.2017, kancelari i Gjykatës së Lartë i ka bërë atij të ditur se çështja penale për rekursin e tij është regjistruar në atë gjykatë në datën 8.9.2017 dhe se ajo ndodhej në fazën e studimit e në pritje për të kaluar në dhomën e këshillimit.

7. Për sa i përket rekursit të kërkuarit, me vendimin nr. 00-2021-419, datë 15.6.2021, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk është nënshkruar nga mbrojtësi, sipas parashikimeve të nenit 435, pika 2, të KPP-së. Sipas kësaj gjykatë, kërkuari është njoftuar nga sekretaria gjyqësore për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi ligjor, ndërkohë që ka kthyer përgjigje se gjykata ka detyrimin t'i caktojë mbrojtës kryesisht. Ajo ka çmuar se kërkuari nuk është në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme dhe as nuk rezulton të ketë paraqitur kërkesë për ndihmë juridike dytësore falas, sipas ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” (ligji nr. 111/2017).

8. Në datën 24.11.2022 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se i ka cenuar të drejta kushtetuese. Në datën 13.3.2023 Kolegji ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa në datën 21.3.2023 kjo e fundit ka vendosur kalimin e çështjes

për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. *Kërkuari*, në mënyrë të përmblodhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tij për shkak të mosnënshkrimit nga mbrojtësi, ndërkohë që ai ka kërkuar mbrojtje kryesisht për këtë qëllim, bazuar në ligjin për ndihmën juridike falas.

9.2. *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi në kundërshtim me nenin 435, pika 2, të KPP-së, Gjykata e Lartë nuk ka pranuar kërkesën e tij për t'iu caktuar një mbrojtës kryesisht.

9.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk është shprehur për faktet e provat shkresore që ai ka dërguar në lidhje me garantimin e mbrojtjes kryesisht, ndërkohë që arsyeton se kërkuari nuk ka kërkuar ndihmë juridike dytësore falas. Kjo gjykatë nuk ka verifikuar veprimet e sekretarisë gjyqësore përpara se të vendoste mospranimin e rekursit.

10. *Subjekti i interesuar*, Prokuroria e Përgjithshme, ka parashtruar se:

10.1. Gjykata e Lartë i ka cenuar kërkuarit *të drejtën e aksesit në gjykatë*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, duke interpretuar nenin 435, pika 2, të KPP-së në mënyrë formale, të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe fjalia vijuese e kësaj dispozite procedurale. Në kundërshtim nga sa ka arsyetuar kjo gjykatë, kërkuari ka paraqitur kërkesë për ndihmë juridike falas, e cila është pranuar me vendimin nr. 782, datë 25.9.2017, të KSHNJ-së. Duke vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk është nënshkruar nga mbrojtësi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka përmblodhur detyrimin për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1,



shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual të datës 24.11.2022 kërkuesi ka ngritur pretendime lidhur me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, ndërsa në parashtrimet e datës 20.4.2023 për çështjen, ka kërkuar edhe shfuqizimin si antikushtetues të nenit 435, pika 2, të KPP-së, në pjesën që parashikon detyrimin për nënshkrimin e aktit të rekursit nga mbrojtësi dhe cilësimin juridik të subjektit si “i pandehur” dhe jo “i dënuar”. Gjykata, bazuar në nenin 43/b, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenin 30, pika 2, të Rregullores së saj për Procedurat Gjyqësore, që parashikon se kërkuesi, në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit, ka vendosur pranimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 435, pika 2, të KPP-së.¹

13. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, Gjykata çmon se, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në këtë proces, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Po kështu, kërkuesi ka plotësuar edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë ka përmbyllur procesin gjyqësor për akuzën penale në ngarkim të

tij. Në këto kushte, ai nuk ka më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e të drejtave që pretendon se i janë cenuar.

14. Në drejtim të legjitimitimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 15.6.2021, ndërsa ankimi kushtetues individual është depozituar përmes shërbimit postar në datën 24.11.2022. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, kërkuesi ka pretenduar se për vendimin e kundërshtuar është vënë në dijeni nga një tjetër gjykatë, gjatë dhënies së aktit të kërkuar prej tij, i cili në faqen e fundit mbante shënimin për mënyrën e përfundimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Po sipas tij, kopja e vendimit të arsyetuar i është vënë në dispozicion në datën 1.11.2022, pas kërkesës së datës 25.10.2022 drejtuar Gjykatës së Lartë për këtë qëllim.

15. Gjykata vëren se gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë kërkuesi ndodhej në kushtet e kufizimit të lirisë personale për efekt të vuajtjes së dënimit të dhënë ndaj tij. Nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton se çështja është shpallur në rubrikën “Çështje për gjykim” të kësaj gjykate dhe mënyra e disponimit për mospranimin e rekursit është njoftuar në rubrikën “Informacion mbi çështjet penale për shqyrtim në dhomë këshillimi të datës 15 qershor 2021”, ndërkohë që vendimi i plotë e i arsyetuar objekt i ankimit kushtetues individual nuk rezulton të jetë publikuar.

16. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë faktin se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje përmes rekursit të paraqitur dhe nënshkruar nga kërkuesi, i cili ka qenë i izoluar pranë institucionit të vuajtjes së dënimit, rrethanë kjo që sipas jurisprudencës së Gjykatës vështirëson marrjen e dijeni për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga njoftimi me shpallje (*shih vendimin nr. 14, datë 21.6.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), dhe se vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë nuk është publikuar në faqen zyrtare të saj, për qëllime të gjykimit kushtetues konkret, si moment i konstatimit të cenimit do të konsiderohet data 1.11.2022, kur me

¹ Votuan për pranimin e kërkesës për shtimin e objektit të gjykimit gjyqtarët Holta Zaçaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahim. Votuan kundër pranimin të

kërkesës për shtimin e objektit të gjykimit gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska dhe Marjana Semini.



shkresën nr. 5674/1 prot., datë 31.10.2022, të Gjykatës së Lartë kërkuesit i është vënë në dispozicion kopja e vendimit të arsyetuar, objekt ankimi kushtetues individual konkret. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* në pretendimet e tij lidhur me procesin gjyqësor.

17. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së tij për proces të rregullt ligjor, në aspekt të së drejtës së aksesit, së drejtës së mbrojtjes dhe standardit të arsyetimit të vendimit, pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues.

18. Për sa u takon pretendimeve që kanë të bëjnë me përmbajtjen e dispozitës ligjore, konkretisht nenit 435, pika 2, të KPP-së, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se, krahas vendimit gjyqësor, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriterë: i. legjitimiteti *ratione personae*, në kuptimin që individ i provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; ii. shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individ i provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; iii. legjitimiteti *ratione temporis*, në kuptimin që individ ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; iv. dhe legjitimiteti *ratione materiae*, në kuptimin që individ i provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata vëren se kërkuesi plotëson kriteret paraprake të legjitimitetit *ratione personae* dhe *shterimit të mjeteve juridike efektive* edhe në lidhje me këtë kërkim, pasi dispozita e kundërshtuar nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore, ajo është

zbatuar drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë në procesin e zhvilluar ndaj tij dhe kërkuesi nuk ka më mjete në dispozicion për kundërshtimin e saj.

20. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis* dhe legjitimitetit *ratione materiae*, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.²

21. Për sa më lart, si dhe duke pasur parasysh se në thelb të pretendimeve për cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës së mbrojtjes dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të parashtruar nga kërkuesi në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, qëndron vendimmarrja e kësaj të fundit për mospranimin e rekursit të nënshkruar nga kërkuesi, Gjykata vlerëson t'i analizojë ato në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë

22. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta e aksesit, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tij për shkak të mosnënshkrimit nga mbrojtësi, ndërkohë që ai ka kërkuar mbrojtje kryesisht për këtë qëllim, bazuar në ligjin për ndihmën juridike falas. Gjykata e Lartë nuk ka pranuar kërkesën e tij për t'iu caktuar një mbrojtës kryesisht, në kundërshtim me nenin 435, pika 2, të KPP-së dhe nuk është shprehur për faktet e provat shkresore që i ka dërguar në lidhje me garantimin e kësaj mbrojtjeje, ndërkohë që arsyeton se nuk ka kërkuar ndihmë juridike dytësore falas. Kjo gjykatë nuk ka verifikuar veprimet e sekretarisë gjyqësore përpara se të vendoste mospranimin e rekursit.

23. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka pranuar pretendimet e kërkuesit, duke parashtruar se Gjykata e Lartë i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, duke interpretuar nenin 435, pika 2, të KPP-së në mënyrë formale dhe të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe fjalë vijuese e kësaj dispozite procedurale. Po sipas kësaj prokurorie, në kundërshtim nga sa ka arsyetuar Gjykata e Lartë, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për ndihmë juridike falas, e cila është pranuar me vendimin nr. 782, datë

² Gjyqtari Sandër Beci votoi kundër legjitimitetit *ratione temporis* të kërkuesit për shfuqizimin e nenit 435, pika 2, të KPP-së. Gjyqtarët Holta Zaçaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja

dhe Genti Ibrahim i votuan kundër legjitimitetit *ratione materiae* të kërkuesit për shfuqizimin e nenit 435, pika 2, të KPP-së.



25.9.2017, të KSHNJ-së. Duke vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk është nënshkruar nga mbrojtësi, Kolegji Penal i saj nuk ka përmbushur detyrimin për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

24. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim të drejtë, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Thelbi i së drejtës së aksesit në gjykatë cenohet kur rregullat procedurale pushojnë së shërbyeri qëllimit të administrimit të duhur të drejtësisë dhe formojnë një lloj pengese për palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të vendoset në themel nga gjykata kompetente. Në veçanti, çështja e administrimit të duhur të drejtësisë është element kryesor për të bërë dallimin midis formalizmit të tepruar dhe zbatimit të pranueshëm të formaliteteve procedurale (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 19, datë 1.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Sipas Gjykatës, rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim, sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta e aksesit në atë gjykatë. Kërkesa për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi, me pasojë mospranimin e tij, e parashikuar nga neni 435 i KPP-së, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikojnë dispozitat procedurale. Mbrojtja me avokat e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë është kërkesë e nevojshme në funksion të garantimit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale që është në interes të drejtësisë. Qëllimin e ligjvënësit për të garantuar mbrojtës në këtë proces e shpreh edhe detyrimi që kjo normë i ngarkon kryetarit të kolegjit, për të caktuar një mbrojtës kryesisht për të pandehurin, i cili nuk ka mbrojtës të zgjedhur (*shih*

vendimet nr. 6, datë 22.2.2022; nr. 21, datë 29.4.2013; nr. 53, datë 5.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

26. Po kështu, Gjykata ka theksuar se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në KPP, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Trajtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 53, datë 5.2.2012; nr. 29, datë 15.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata vëren se neni 435, pika 2, i KPP-së, në fuqi në datën e depozitimit të rekursit të kërkuarit, me të njëjtën përmbajtje edhe aktualisht, parashikonte: “*Akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësit. Kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur, kryetari i kolegjit cakton një mbrojtës kryesisht dhe në këtë rast lajmërimet i bëhen edhe të pandehurit*.”. Sipas nenit 49 të KPP-së së kohës: “*1. I pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që ka mbetur pa të, ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar nga organi që procedon, në qoftë se e kërkon atë. ... 4. Gjykata, prokurori dhe policia gjyqësore, kur duhet të kryejnë një veprim për të cilin parashikohet ndihma e mbrojtësit dhe kur i pandehuri është pa mbrojtës, njoftojnë për këtë veprim mbrojtësin e caktuar*.”.

28. Nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues të çështjes, Gjykata vëren se kërkuar është proceduar penalisht dhe gjykuar për veprat penale “Kallëzimi i rremë” dhe “Mashtrimi”, të parashikuara nga nenet 305 dhe 143/2 të KP-së. Ai është mbrojtur vetë në gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, gjatë të cilit, edhe pse në disa seanca, për shkak të mungesës së tij, ka qenë i pranishëm mbrojtësi i caktuar kryesisht, Q.M., gjykata nuk ka vijuar me shqyrtimin e çështjes, por ka vendosur shtyrjen e gjykimit për një datë tjetër. Po kështu, kërkuar është mbrojtur vetë edhe në gjykatën e apelit, e cila, në përfundim të gjykimit ka vendosur mospranimin e ankimit të tij, për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor 10-ditor. Në vijim, ai i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs të nënshkruar prej tij. Me shkresë të kancelarit të Gjykatës së Lartë dosja gjyqësore është kthyer pa veprim, për shkak të mosnënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi, sipas nenit 435/2 të KPP-së. Kërkuar është njoftuar për këtë me shkresë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Në këto kushte, në funksion të plotësimi të së metës së konstatuar të rekursit, ai



ka depozituar një akt me shkrim duke i kërkuar Gjykatës së Lartë caktimin e një mbrojtësi kryesisht, bazuar në nenin 435, pika 2, të KPP-së, në kushtet kur nuk kishte të tillë. Pas kësaj, rekursi është regjistruar për shqyrtim dhe, pas kërkesës për informacion, kërkuesit i është bërë i ditur ky fakt. Pas shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tij, për shkak të mosnënshkrimit nga mbrojtësi. Sipas kësaj gjykate, kërkuesi nuk ndodhej në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme dhe nuk rezultonte të kishte paraqitur kërkesë për ndihmë juridike dytësore falas, referuar ligjit nr. 111/2017.

29. Në analizë të vendimit të kundërshtuar, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, në zbatim të fjalisë së parë të nenit 435, pika 2, të KPP-së, e cila parashikon si kërkesë formale për paraqitjen e rekursit nënshkrimit të tij nga mbrojtësi. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se fjalja e dytë e kësaj dispozite parashikon se kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur, kryetari i kolegjit cakton një mbrojtës kryesisht dhe në këtë rast lajmërimet i bëhen edhe të pandehurit. Në referim të këtij parashikimi ligjor, në rastin e plotësimit të të metave të konstatuara të rekursit, kërkuesi ka kërkuar nga Gjykata e Lartë caktimin kryesisht të një mbrojtësi për të, në rrethanat kur nuk kishte një të tillë. Kjo kërkesë nuk është pranuar dhe në vendimin për mospranimin e rekursit Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kërkuesi nuk është në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme, megjithëse parashikimi ligjor në fjalë, pjesë e dispozitës që rregullon paraqitjen e rekursit, caktimin kryesisht të mbrojtësit në Gjykatën e Lartë e ka lidhur vetëm me situatën kur i pandehuri nuk ka mbrojtës. Gjykata e Lartë nuk arsyeton se si mund të plotësohet kërkesa e ligjit procedural penal për paraqitjen e rekursit kundrejt nënshkrimit nga mbrojtësi në rastin e një të pandehuri që nuk ka një të tillë dhe, në këtë kuptim, si i garantohet këtij të pandehuri e drejta e aksesit në këtë gjykatë.

30. Po kështu, në vendimin për mospranimin e rekursit, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kërkuesi nuk kishte paraqitur kërkesë për ndihmë juridike dytësore falas, referuar ligjit nr. 111/2017. Ndryshe nga sa arsyeton kjo gjykatë, Gjykata vëren se nga materialet e vëna në dispozicion për çështjen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë, e cila, me shfuqizimin e ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, me ligjin

nr. 111/2017, ka zëvendësuar KSHNJ-në (neni 36, pika 1, i ligjit nr. 111/2017), në datën 16.8.2017 kërkuesi i është drejtuar KSHNJ-së me kërkesë për caktimin e një mbrojtësi për nënshkrimin e rekursit. Me urdhrin nr. 782, datë 25.9.2017, KSHNJ-ja ka caktuar avokatin G.R. për ofrimin e ndihmës juridike ndaj tij, në formën e përfaqësimit në çështjen penale me objekt: “*Rekurs penal ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë*”. Nga ana tjetër, aktet dhe raportin përfundimtar të saj, përfshirë dhe rekursin e nënshkruar prej mbrojtësit të caktuar si pjesë e ndihmës juridike të ofruar për kërkuesin, nuk rezulton që KSHNJ-ja, në kuadër të bashkëpunimit institucional, t’ia ketë përcjellë Gjykatës së Lartë për qëllime të garantimit të së drejtës së aksesit të kërkuesit në këtë gjykatë, pavarësisht faktit se ajo ka qenë në fazën e suprimimit të saj për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr. 111/2017, duke mos kryer kështu siç duhet detyrat e saj.

31. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, pavarësisht kërkesës së kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk i ka siguruar atij një mbrojtës për t’i mundësuar ushtrimin efektiv të së drejtës së rekursit, në kushtet kur ai nuk ka pasur një të tillë gjatë procesit, ndërkohë që ligji kërkon nënshkrimin e rekursit nga një mbrojtës. Duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit në këtë gjykatë. Për më tepër, ajo ka vendosur mospranimin e rekursit, ndonëse kërkuesi ankohej pikërisht për cenimin e së drejtës së aksesit nga Gjykata e Apelit Tiranë, si rrjedhojë e llogaritjes së gabuar nga kjo e fundit të afatit të paraqitjes së ankimit, konkretisht llogaritjes si datë fillimi të kohës së shpalljes së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, ndonëse ky vendim ishte shpallur në mungesë të tij.

32. Po kështu, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk kishte paraqitur kërkesë për ndihmë juridike dytësore falas, referuar ligjit nr. 111/2017, duke nënkuptuar se ai nuk kishte bërë përpjekjet e duhura për plotësimin e të metave të rekursit, pra nënshkrimin e tij nga një mbrojtës, qoftë ky edhe i caktuar kryesisht në kuadër të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Gjykata vëren se ky përfundim i Gjykatës së Lartë nuk është në përputhje me atë çka në të vërtetë ka ndodhur, për sa kohë, në gjendjen që aktet kanë qenë, verifikimi i kësaj rrethane ka qenë i pamundur në kushtet kur organi publik (KSHNJ-ja), por edhe



kërkuesi, nuk e kanë njoftuar atë lidhur me këtë zhvillim. Nga ana tjetër, ky përfundim i Gjykatës së Lartë, ndryshe nga përfundimi i saj për mospasjen të drejtë kërkuesi për të pasur një mbrojtës kryesisht për paraqitjen e rekursit, për shkak të mosqenies së tij në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme, lë të kuptohet se garantimi i aksesit të kërkuesit në atë gjykatë, për sa i përket paraqitjes së rekursit kundrejt nënshkrimit të tij nga një mbrojtës, ka qenë i mundur përmes realizimit për atë të së drejtës për ndihmë juridike nga shteti. Thënë kjo, duket se Gjykata e Lartë pranon se kërkuesi ka pasur të drejtën e ndihmës juridike nga shteti, por se ajo nuk është realizuar për shkak të mosveprimit të tij. Nisur nga një vlerësim i tillë për këtë të drejtë të kërkuesit, si dhe rëndësinë që i është dhënë asaj nga vetë Gjykata e Lartë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, për arritjen në përfundimin e mosveprimit të kërkuesit në lidhje me realizimin e kësaj të drejtë, Gjykata e Lartë duket që nuk ka pasur informacionin e plotë për çështjen dhe arsyetimi i saj përmban pasaktësi në këtë drejtim. Rezulton se kërkuesi ka kërkuar ofrimin e ndihmës juridike nga shteti për nënshkrimin e rekursit dhe kërkesa e tij është pranuar nga organi publik (KSHNJ-ja), por ky i fundit nuk i ka përcjellë Gjykatës së Lartë informacionin e duhur në këtë drejtim, përveç se nuk ka verifikuar ndihmën juridike të ofruar në fakt për kërkuesin nga mbrojtësi i caktuar, i cili ka dhënë vetëm konsulencë ligjore dhe jo ndihmën juridike të urdhëruar prej tij. Si pasojë e mungesës së informacionit të duhur edhe Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar ofrimin e ndihmës juridike nga mbrojtësi i caktuar për kërkuesin.

33. Gjykata thekson se detyrimi ligjor për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi, i përcaktuar në nenin 435, pika 2, të KPP-së, përbën një garanci të shtuar në drejtim të aksesit të individit në Gjykatën e Lartë, si gjykatë e ligjit, dhe nuk mund të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të atillë sa të çojë në kufizimin e kësaj të drejte. Në kontekstin e rastit konkret, Gjykata vlerëson se mosgarantimi i mbrojtësit kryesisht nga Gjykata e Lartë, arsyetimi i pasaktë i kësaj gjykate në vendim se kërkuesi nuk kishte paraqitur kërkesë për ndihmë juridike dytësore falas dhe mangësitë në bashkëpunimin ndër-institucional mes saj dhe KSHNJ-së, kanë cenuar thelbin e së drejtës së kërkuesit për akses në Gjykatën e Lartë. Gjykata çmon se Gjykata e Lartë i ka të gjitha hapësirat që, në përputhje me funksionin e saj të interpretimit të normës, kërkesat ligjore për

elementet formale që duhet të plotësojë rekursi t'i interpretojë me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së aksesit në gjykatë.

34. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit, sipas arsytimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës pjesërisht.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-419, datë 15.6.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.10.2023.

Shpallur më 2.11.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

MENDIM PJESËRISHT PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Ilir Muzhaqi, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-419, datë 15.6.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i nenit 435, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në pjesën që parashikon detyrimin për nënshkrimin e aktit të rekursit nga mbrojtësi dhe cilësimin juridik të subjektit si “i pandebur” dhe jo “i dënuar”*”, vlerësojmë se kërkuesi nuk kishte



paraqitur kërkesë për shtimin e objektit të ankimit, ndaj nuk kishte vend që kjo çështje të shtrohej për shqyrtim dhe vendimmarje.

2. Në datën 24.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, në objektin e të cilit ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-419, datë 15.6.2021, të Gjykatës së Lartë, me të cilin ishte vendosur mospranimi i rekursit të tij, për shkak se ai nuk ishte nënshkruar nga mbrojtësi, sipas nenit 435, pika 2, të KPP-së. Mbledhja e Gjyqtarëve, në datën 21.3.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe ka njoftuar palët pjesëmarrëse, përfshirë kërkuenin. Në përgjigje të këtij njoftimi, kërkuesi, në datën 20.4.2023, ka paraqitur parashtrime me shkrim të formuluar në mënyrë të përmbledhur (gjithsej, gjysmë faqe me 4 paragrafë), ku është shprehur se *“Me këtë parashtrim, seanca plenare duhet të analizojë edhe për sa i takon parashikimit të nënshkrimit të aktit të rekursit nga mbrojtësit, sepse Gjykata e Lartë duhet ta vërejë atë të lidhur ngushtë me shkaqet e paraqitura në aktin e rekursit, duke mos qenë e nevojshme prania e asnjërit nga mbrojtësit me nënshkrimet e tyre. Kjo, sepse Gjykata e Lartë ka pasur dhe vazhdon të ketë në dispozicion të saj vendimin unifikues nr. 5, datë 15.9.2009, të Kolegjeve të Bashkuara, por që me hyrjen në fuqi të shumë ndryshimeve ligjore me drejtësinë e re edhe ky vendim, edhe vetë neni 435/2 i KPP-së duhet të gjejnë ndryshime në garantimin e mbrojtjes duke e lidhur atë me parashikimet e ligjit procedural penal dhe me shkaqet e ngritura në aktin rekursues”* (shih paragrafët e tretë dhe të katërt të parashtrimeve).

3. Mbështetur në këto parashtrime, shumica ka vlerësuar se kërkuesi ka kërkuar edhe shfuqizimin si antikushtetues të nenit 435, pika 2, të KPP-së, në pjesën që parashikon detyrimin për nënshkrimin e aktit të rekursit nga mbrojtësi dhe cilësimin juridik të subjektit si “i pandehur” dhe jo “i dënuar” dhe bazuar në nenin 43/b, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenin 30, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës (rregullorja), ka vendosur pranimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 435, pika 2, të KPP-së (shih paragrafin 12 të vendimit).

4. Ky vlerësim i shumicës, në këndvështrimin tonë, duket i sforcuar dhe në tejkalim të objektit të ankimit, me të cilin është vënë në lëvizje gjykimi kushtetues, ndaj krijon një precedent të pasaktë lidhur me kriteret e pranueshmërisë së kërkesave drejtuar Gjykatës dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes prej saj, në kuptim të nenit 48, pika 1, të ligjit nr.

8577/2000. Kuadri normativ që rregullon funksionimin e Gjykatës ka parashikuar, ndër të tjera, të drejtat e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, ku përfshihet edhe e drejta e individit ankues për të kërkuar, në çdo fazë, pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit ose heqjen dorë nga kërkesa, me kusht që të paraqitet me shkrim dhe përpara marrjes së vendimit (neni 43/b, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 30, pika 2, i rregullores). Një kërkesë e tillë duhet të ketë të njëjtën qasje formale dhe përmbajtësore me ankimin kushtetues individual, pra të tregojë në mënyrë të qartë, të plotë dhe të saktë vullnetin e kërkuetit për shtimin ose pakësimin e objektit të kërimit, së bashku me argumentet kushtetuese të mjaftueshme se përse kërkohet dhe pse pikërisht në këtë fazë.

5. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, vërejmë se në parashtrimet e paraqitura në datën 20.4.2023, kërkuesi në asnjë paragraf dhe rresht të tyre, as formalisht dhe as në përmbajtje, nuk ka kërkuar “shtesë objekt” dhe/ose “shfuqizimin e nenit 435, pika 2 të KPP-së”, si dhe nuk ka paraqitur asnjë argument mbështetës në këtë drejtim. Nga ana përmbajtësore, ato çfarë ai ka shprehur nëpërmjet parashtrimeve më së shumti kuptohen si argumente shtesë të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë si pasojë e mungesës së nënshkrimit të mbrojtësit në rekursin e paraqitur prej tij. Me fjalë të tjera, nuk rezulton që kërkuesi të ketë kërkuar as shprehimisht dhe as në mënyrë të nënkuptuar kontrollin kushtetues të nenit 435, pika 2, të KPP-së, në pjesën që parashikon detyrimin për nënshkrimin e aktit të rekursit nga mbrojtësi dhe cilësimin juridik të subjektit si “i pandehur” dhe jo “i dënuar”, sikurse i ka interpretuar dhe vlerësuar shumica parashtrimet e tij të datës 20.4.2023.

6. Për sa më lart, vlerësojmë se shumica nuk kishte ndonjë bazë që të shqyrtonte dhe të vendoste mbi çështjen e pranueshmërisë së kërkesës për shtimin e objektit të ankimit kushtetues individual.

Anëtarë: Marjana Semini, Ilir Toska, Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari



VENDIM
Nr. 13, datë 31.10.2023

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË RREGULLOREN PËR
PROCEDURAT GJYQËSORE TË
GJYKATËS KUSHTETUESE

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

më datë 31.10.2023, mori në shqyrtim projektin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese” dhe relacionin shoqërues të tij.

Mbledhja e Gjyqtarëve, në mbështetje të nenit 13, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në Rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 31.10.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska

Në Rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Stema e Gjykatës përmban simbolin e shqiptonjës dykrenore me ngjyrë të artë dhe të kuqe. Mbi kokat e shqiptonjës është vendosur përkrenarja e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Në zemër të shqiptonjës është vendosur një medalje rrumbullake rreth e qark së cilës është shkruar Republika e Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese dhe nën të modelohen gjethe të dushkut me ngjyrë jeshile. Në qendër të medaljes ngrihet mbi një sfond blu peshorja e drejtësisë. Në pjesën mbështetëse të peshores gdhendet “viti 1992”.”.

Neni 2

Në nenin 32, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Pjesëmarrësit në gjykim nuk përfitojnë nga e drejta për t’u njohur me aktet e ndërmjetme, ku përfshihen: aktet ose materialet e përgatitura nga këshilltari ose strukturat e tjera për qëllime të vendimmarrjes; shënimet e relatorit; projektvendimet; procesverbalet e vendimmarrjes dhe të votimit të gjyqtarëve.”.

Neni 3

Në nenin 28, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3.1 Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pjesëmarrësve në gjykim u kërkohet adresa e postës elektronike, në rast se nuk e kanë paraqitur më parë atë, me qëllim lehtësimin dhe realizimin e komunikimit deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, përfshirë njoftimin për shpalljen e vendimit të arsyetuar të Gjykatës.”.

Neni 4

Në nenin 34, pika 3, shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) mosmbajtja e telefonit celular gjatë zhvillimit të seancës plenare. Përgjatshëm, palët mund të mbajnë pajisje të tjera elektronike (tablet, laptop ose të ngjashme me to) për të siguruar mbajtjen e



shënimeve gjatë seancës dhe në funksion të mbrojtjes në gjykim.”.

Neni 5

Në nenin 42, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pas përgatitjes së variantit përfundimtar të vendimit të Gjykatës, këshilltari ligjor ia përcjell Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit, e cila merr masat për nënshkrimin e tij nga të gjithë gjyqtarët që kanë marrë pjesë në gjykim. Pas nënshkrimit të vendimit, Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit njofton për datën dhe orën e shpalljes së vendimit pjesëmarrësit në gjykim nëpërmjet postës elektronike, nëse ata kanë paraqitur adresën e saj ose me shkresë”.

VENDIM

Nr. 287, datë 9.10.2023

MBI PROPOZIMIN PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS SË TARIFAVE NË ALPEX DHE MIRATIMIN E LISTËS SË TARIFAVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 3.5; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 3, pika 8, të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO); si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 6.3.2020; neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”, të datës 21.10.2021, nënshkruar nga Enti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST sh.a.) dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a.); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.10.2023, pasi shqyrtoi

relacionin me nr. 1991/1 prot., datë 5.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi propozimin për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX dhe miratimin e listës së tarifave”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a. me shkresën nr. 257, datë 31.7.2023, protokolluar me tonën me nr. 1991 prot., datë 2.8.2023, ka paraqitur në ERE “Propozimin për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX dhe miratimin e listës së tarifave”.

- ALPEX sh.a., në kërkesën e paraqitur në ERE ka bashkëlidhur dhe draftdokumentin “Metodologjia për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX”, i cili përfshin propozimin e ALPEX për metodologjinë e përcaktimit të strukturës së tarifave dhe propozimin e listës së tarifave të ALPEX sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për tregjet e Shqipërisë dhe Kosovës. Në kuadër të marrëveshjes kornizë të nënshkruar ndërmjet ERE-s dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji të Kosovës (ZRRE), “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”, më datë 21.10.2021, propozimi është paraqitur në të njëjtën kohë edhe pranë ZRRE-së, në mënyrë që kjo metodologji të aprovohet me të njëjtën përmbajtje.

- Në përcaktimin e strukturës së tarifave për anëtarët pjesëmarrës në tregjet e ALPEX-it, sipas shoqërisë është marrë në konsideratë objektivi që kapitali neto i saj të jetë i barabartë me kapitalin e nënshkruar. Dokumenti, gjithashtu, përmban parimet e përcaktimit të strukturës së tarifave dhe një krahasim të nivelit të tarifave krahasuar me nivelin e tarifave në bursat rajonale.

- ERE vlerëson se metodologjia e propozuar nga ALPEX-i përmbush kriteret minimale për zhvillimin e procesit konsultativ me palët e interesit dhe fillimin e procedurës, me qëllim përditësimin e saj për hartimin e një metodologjie të strukturuar qartë, sikurse metodologjitë e tarifave ekzistuese, të cilat janë miratuar nga ERE dhe janë të zbatueshme për segmente të tjera të sektorit të energjisë elektrike.

- Lista e tarifave e propozuar nga ALPEX sh.a. do të jetë e aplikueshme përkohësisht për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri në momentin e miratimit të tyre bazuar në një metodologji të strukturuar qartë,



ku të përcaktohet metoda e përlogaritjes së tarifave dhe periudha rregullatore.

- Me fillimin e procedurave për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), shoqëria ALPEX sh.a. duhet të vijojë me përditësimin e metodologjisë gjatë procesit të konsultimit publik, në mënyrë që ERE të vijojë me shqyrtimin dhe miratimin e saj.

- ERE, në zbatim të nenit 6, pikave 6.1 dhe 6.4 të marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, të datës 21 tetor 2021, duhet të bashkëpunojë me ZRRE-në për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), dokument i cili në përfundim duhet të bazohet në parime dhe metoda të njëjta të mbështetura në aktet ligjore në fuqi, sipas secilit juridiksion.

- ALPEX sh.a., në përditësimin e Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), duhet të mbështetet në konstatimet e këtij vendimi, si dhe në konstatimet e vendimit të Bordit të ZRRE-së të datës 21 shtator 2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Listës së tarifave të ALPEX”, të cilat do jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) deri më 31.3.2024 (tabela bashkëlidhur).

2. Fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifave” të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), mbështetur në konstatimet e këtij vendimi. (bashkëlidhur draftmetodologjia)

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojnë shoqërinë ALPEX sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Administrative	Një herë	200 €	Anëtar i Bursës
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	Një herë	7,000 €	Anëtar i Bursës
Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	Një herë	5,000 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës	Vjetore	10,000 €	Anëtar i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	Vjetore	2,000 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	6,000 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh	Transaksion	0.070 €	Anëtar i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	Transaksion	0.020 €	Anëtar i Bursës
Tarifa e Tregtimit në Emër të Dikujt Tjetër	Urdhërporosi	20 €	Anëtar i Bursës
Tarifa për API Përdorues	Vjetore	2,000 €	Anëtar i Bursës
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal të Klerimit	Mujore	100 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa e Administrimit të Letër Garancisë Bankare	Kur depozitohet	50 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa vjetore e Trajnimit	Vjetore	200 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Tarifa e Provimit	Vjetore	100 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Certifikata digjitale për përdorues	Vjetore	50 €	Anëtar i Bursës / Anëtar i Klerimit

- Për tregun e Shqipërisë të gjitha tarifat do të shlyen në monedhën euro për jorezidentët.
- Për tregun e Shqipërisë të gjitha tarifat fikse do të shlyen në monedhën lek, ekuivalent të referencës së përcaktuar në monedhën euro për rezidentët.
- Mbi tarifat do të aplikohet TVSH-ja.

METODOLIGJIA

PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS SË TARIFAVE NË ALPEX

Konsiderata të përgjithshme

Lista e Tarifave aktuale të ALPEX është aplikuar prej fillimit të operimit të ALPEX-it për zonën e ofertimit të Shqipërisë. Prej asaj kohe, ALPEX ka vlerësuar ndikimin e strukturës së tarifave për të përmirësuar situatën e vetë financiare ose për të akomoduar çdo kërkesë për ndryshim nga anëtarët e bursës. Tregu i energjisë ka ndryshuar me prezencën e më shumë aktorëve të rinj dhe priten të tjerë aktorë duke sjellë kompleksitet më të madh, i cili përfshin prezantimin e tregjeve të tjera rajonale, rritje më të shpejtë të burimeve të rinovueshme dhe zhvillimin e teknologjisë në tërësi.

Më konkretisht, kërkohet sa më shumë automatizim i proceseve me sisteme të reja, standardizimi i proceseve në ALPEX në funksion të sigurisë së informacionit, zhvillimi i stafit, prezenca e ALPEX-it në forume, panairë dhe konferenca rajonale dhe europiane. Të gjitha këto sfida dhe ndryshime kërkojnë adoptimin me teknologji dhe të shpenzimeve operative për ALPEX.

Pasqyrat financiare të ALPEX-it 2022 raportojnë që zëri i shpenzimeve i atribuohet shpenzimeve të personelit (57%), shpenzimet e tjera të shfrytëzimit (36%). Vlera neto e aktiveve është rreth 9.5 milion lek.

Në përcaktimin e strukturës së tarifave për anëtarët pjesëmarrës në tregjet e ALPEX-it, është marrë në konsideratë objektivi që kapitali neto i shoqërisë të jetë i barabartë me kapitalin e nënshkruar, atë në vlerën 250 milion lekë deri në fund të vitit 2028 sipas kalendarit, tabela nr.2. Për më tepër, kjo struktura tarifash duhet të ndjekë parimet e mëposhtme:

- Struktura e tarifave për pjesëmarrësit në tregjet e ALPEX-it duhet të jetë e njëjtë për të dy tregjet Shqipëri dhe Kosovë.
- Struktura e tarifave për pjesëmarrësit në tregjet e ALPEX-it duhet të jetë e thjeshtë.
- Komponentët e tarifave për pjesëmarrësit në tregjet e ALPEX-it që ngarkojnë çdo pjesëmarrës duhet të reflektojnë në një farë mase kërkesat për të ardhura të buxhetuara.
- Tarifat për pjesëmarrësit nuk duhet në mënyrë të paarsyeshme apo të diskriminojnë ndonjë kategori pjesëmarrësish.
- Tarifat janë vendosur mbi bazë fitimi pas vitin 2024 dhe deri në vitin 2028 do gjenerojnë fitim progresiv deri sa kapitali neto të jetë 250 milion lek.
- Pas vitit 2028 kur të arrihet targeti i mësipërm, tarifat do të vendosen mbi parimin e mos krijimit të ardhurave si qëllim në vetvete, por vetëm do mbulojnë totalin e kostove. Kthimi nga kapitali ROE do të jetë në masën 5% në vit me qëllim për ta bërë ALPEX-in me atraktiv në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhshmes, atë të riorganizimit të tregjeve të energjisë në europë.

ALPEX është shumë i vetëdijshëm për sfidat ekonomike me të cilat përballen konsumatorët dhe pjesëmarrësit e tregut. Ndërsa tarifat e ALPEX përfaqësojnë një komponent shumë të vogël të kostove të përgjithshme të sistemit energjetik, është thelbësore që ne, së bashku me pjesën tjetër të sektorit, të ndërmarrim të gjitha veprimet e kujdesshme për të ofruar shërbimet tona në mënyrë sa më efikase.

- ALPEX është angazhuar në një aktivitet transformues për të mbajtur nën kontroll shpenzimet operative dhe për të përmirësuar shërbimin tonë ndaj anëtarëve, për të përmirësuar praktikën tonë të funksionimit, për të rritur përdorimin tonë të teknologjisë dixhitale dhe për të tërhequr dhe mbajtur talentin më të mirë që mundemi për të siguruar vlerë të qëndrueshme për anëtarët dhe konsumatorët.
- Modeli dhe struktura aktuale e biznesit të ALPEX u krijuan në një kohë shumë të ndryshme me sektorin tonë. Ndryshimet në industri kërkojnë që ALPEX të ketë talentin e duhur, mjetet e



vendimmarrjes dhe sistemet operative për të menaxhuar kompleksitetin në rritje të sektorit dhe për t'u ofruar vlerë konsumatorëve. Investimi i kërkuar kapital mund të jetë i rëndësishëm dhe është thelbësore që të kuptohet dhe që ne të punojmë me anëtarët tanë për t'u siguruar që mund të ofrojmë shërbimet që ata kërkojnë në një mënyrë që është efikase, ofron mundësi për të reduktuar kostot e pranueshme prej pjesëmarrësit dhe mbështet aftësinë e sektorit për të përfituar nga ndryshimet teknologjike, për të përfitimet e konsumatorëve të energjisë elektrike; dhe

- ALPEX është angazhuar për të fituar dhe ruajtur besimin e të gjithë palëve të interesit dhe ne besojmë se transparenca, integriteti i informacionit dhe në kohën e duhur, konsultimi dhe bashkëpunimi janë çelësi për arritjen e këtij besimi.

1. Prezantimi dhe Kuptueshmëria

Struktura aktuale e tarifave të anëtarëve të Bursës dhe anëtarëve të klerimit në tregjet e energjisë elektrike të ALPEX është vendosur më 24 mars 2023 sipas Vendimit Teknik Nr. 5-C për "Listën e Tarifave të ALPEX". Lista e Tarifave në tregjet e energjisë elektrike të ALPEX u publikua në faqen e ueb-it të ALPEX.

Me fillimin e operimit të ALPEX-it për tregun e ditës në avancë fillimisht për zonën e ofertimit të Shqipërisë dhe me planifikimin në shtator 2023 të filloj operimin për tregun e Kosovës, së bashku me bashkimin e tregjeve Shqiperi Kosovë, ALPEX ka planifikuar që në Prill të viti 2024 do të lançojë tregun brenda të njëjtës ditë për zonën e ofertimit të Shqipërisë dhe në muajin qershor 2024 për zonën e ofertimit të Kosovës sëbashku me bashkimin e tyre të tregjeve. Proceset e integritetit të tregjeve Shqipëri-Kosovë me tregjet e tjera rajonal dhe atë evropian janë sfidat në vitet 2025 e në vijim.

Prej fillimit të strukturës aktuale dhe me planifikimin e një strukture të re me fillimin e operacionalizimit të ALPEX-it kanë ndodhur ndryshime të cilat kanë rritur kompleksitetin për parashikimet operationale të tregjeve të ALPEX-it dhe proceseve integrale si dhe kërkesave për raportim rregulator të cilat kanë ndikuar në aktivitetin operacional të tij dhe në veçanti:

- Prezantimi i tre ankandeve në tregun brenda së njëjtës ditë në periudhën Prill-Qershor 2024;
- Aktiviteti operacional në tregtim 24/7;
- Aktivitetet monitoruese duke përdorur teknologjinë e duhur;
- Prezantimi i produkteve 30 dhe 15 minuta;
- Rritja e shpejtë e kapaciteteve të burimeve të rinovueshme;
- Përmirësimi në perdorim i të dhënave; dhe
- Ndryshime në sjelljen e konsumit për konsumatorët.

Ndryshimet e mësipërme kërkojnë që ALPEX-i të rrisë personelin dhe investimet kapitale për të përdorur sisteme që përballojnë sfidat teknologjike të cilat rrisin cilësinë e shërbimit, eliminojnë rreziqet operationale dhe japin modelet e duhura në parashikimet e tregjeve. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, ALPEX ka kërkuar njohjen që shpenzimet efikase do të përmirësojnë tregun e energjisë elektrike dhe mundësojnë rritjen e përfitimeve social-ekonomike të industrisë të energjisë, veçanërisht duke e konsiderur që energjia elektrike është e kudondodhur në ekonominë moderne.



1.1 Parimet e Strukturës së Tarifave

Kjo metodologji propozohet të aplikohet për strukturën e tarifave. Vlera aktuale për çdo tarifë është në procesin e buxhetimit të ALPEX. Sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, ALPEX ka të drejtë të aplikojë tarifat e tregut për anëtarët e regjistruar.

Në përcaktimin e strukturës së tarifave të anëtarëve të bursës, ALPEX duhet të ketë parasysh objektivat dhe struktura e tarifave të tyre duhet, për aq sa është praktike, të jetë në përputhje me një numër parimesh (të referuara në këtë dokument si Parimet e Strukturës së Tarifave) dhe këto janë të përcaktuara, në Tabelën nr.1 me një shpjegim dhe disa shembuj se si mund të zbatohen këto kërkesa për zbatimin e strukturës së tarifës së energjisë elektrike në tregjet Shqipëri-Kosovë.

Table 1 Parimet e aplikueshme për strukturën e tarifave

Parimi i strukturës së Tarifave	Kërkesat	Aplikim dhe shembuj
Objektivi	Në përcaktimin e tarifave të anëtarëve të bursës dhe atyre të klerimit, ALPEX duhet të ketë parasysh objektivin. Objektivi është të promovojmë investime efikase në ekonomitë tona dhe veçanërisht në sektorin energjistik, të promovojmë operimin efikas të sektorit dhe përdorimin e shërbimeve për energjinë elektrike për interesat afatgjata të konsumatorëve që lidhen me: (a) çmimin, cilësinë, sigurinë, besueshmërinë dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike; dhe (b) besueshmërinë dhe sigurinë e sistemit elektro-energjitik	
Thjeshtësia	Struktura e tarifave të anëtarëve të bursës dhe atyre të klerimit në tregjet e ALPEX duhet të jetë e thjeshtë dhe të përmbys shërbimet e dhëna.	ALPEX konsideron se parimi i thjeshtësisë do të thotë se baza e strukturës së tarifës dhe zbatimi i saj për anëtarë të ndryshëm duhet të jetë: • e drejtpërdrejtë • lehtësisht e kuptueshme nga anëtarë e saj • aplikohet lehtësisht nga anëtarë e regjistruar dhe ALPEX • të parashikueshme dhe të pritshme për sa i përket ndikimeve dhe kostove
Jo-diskriminuese	Tarifat e pjesëmarrësve nuk duhet që në mënyrë të paarsyeshme të jenë diskriminuese kundrejt një kategori ose kategori të ndryshme të anëtarëve të regjistruar.	"Diskriminim do të thotë të trajtohet njerëz ose kategori të njerëzve ndryshe ose në mënyrë të pabarabartë. Për më shumë, "diskriminim" ka një përkufizim juridik: "Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo parapëlqim, pavarësisht nga shkaku, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës, nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe nga legjislacioni në fuqi.
Krahasueshmëria	Në zhvillimin, rishikimin dhe publikimin e strukturës së tarifave, ALPEX duhet të marrë parasysh strukturat e tjera të tarifave ekzistuese në tregjet rajonale apo europiane për të cilat mendon se janë të përshtatshme për qëllime krahasimi. Duhet patur parasysh se ky nuk është një parim konkret, por është përfshirë për plotësinë në përshkrimin e çështjet për të cilat ALPEX duhet të ketë parasysh.	Strukturat e tjera përkatëse të tarifave mund të përfshijnë: • Strukturat e tjera të tarifave të tregut të energjisë elektrike si p.sh HUPX, CROPEX, HENEX, IBEX, BSP të paraqitura në Aneksin B.



Nuk ekzitojnë rregulla se cili prej Parimeve të Strukturës së Tarifave duhet të ketë peshë më të madhe se të tjerat. Megjithatë, kur nuk është praktike që ALPEX të përmbushë të gjitha parimet ose t'i plotësojë të gjitha në një shkallë të barabartë, ALPEX mund të miratojë një strukturë që nuk është në përputhje me të gjitha parimet. Prandaj, përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas objektivave zakonisht kërkon një zëvendësim midis parimeve. Kjo do të thotë, një opsion për të përmirësuar strukturën e tarifave kundrejt një parimi i cili mund të pakësojë zbatueshmërinë e një parimi tjetër.

Për shembull, parimet e konkurrencës së zakonshme janë reflektimi i kostos dhe thjeshtësisë. Ndërsa reflektimi i kostos në strukturën e tarifave mund të përmirësohet përmes masave të tilla si ndarja e tarifave, tregjeve ose shërbimeve, e cila do të zvogëlonte thjeshtësinë e strukturës së tarifave.

1.2 Buxhetimi dhe Struktura e Tarifave

Operacionalizimi i ALPEX kërkon që anëtarët e bursës dhe anëtarët e klerimit në tregjet e tij të paguajnë tarifën të përcaktuar në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike / Rregullat e ALPEX-it – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat dhe të detajuara në Listën e Tarifave të ALPEX Aneksi A. Me konkretisht në Rregullat e ALPEX seksioni B.4.5 “Tarifat e ALPEX-it” citohet:

- Kostot operacionale të Tregjeve të Ditës në Avancë dhe atyre Brenda së Njëjtës Ditë mbulohen nëpërmjet pagesave të Tarifave Fikse dhe Variabël nga Anëtarët e Bursës në ALPEX. Tarifat Fikse dhe Variabël propozohen nga ALPEX dhe miratohen me Vendim të Autoritetit Rregullator; dhe
- Tarifat Fikse dhe Variabël aplikohen pas kalimit të një periudhe kohore të përcaktuar në Vendimin e Autoritetit Rregullator të përmendur më lart.

Parashikimet në Procedurën e Klerimi dhe Shlyerjes seksioni G.6.5 “Tarifat e tjera” citohet:

ALPEX-i do të publikojë detajet e Tarifave të tjera fikse, pas miratimit përkatës të tyre.

Ndarjen e llogarive për funksionet e Operatorit të Bashkimit të Tregjeve dhe aktivisteve të tjera për të parandaluar ndër-subvencionimin sipas parashikimeve në rregulloren NEMO.

1.2.1 Aktivitetet operacionale të NEMO

Funksioni bazë për organizmin dhe menaxhimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike nga ALPEX-i në rolin e NEMO përfshin:

- Operimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike për zonën e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës.
- Operimin e klerimit dhe shlyerjes nga transaksionet në tregjet e ALPEX-it për zonën e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës.
- Operimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike për bashkimin e tregjeve të Shqipërisë, Kosovës me tregjet e tjera rajonale dhe ato evropian.
- Të gjitha kostot për shkak të aktivitetit të NEMO për themelin, ndryshimet dhe operimin e tregut/tregjeve të bashkuar të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës dite mbulohen nga tarifën.
- Të gjitha kostot për shkak të aktivitetit të NEMO si kundër palë qendrore ndërkufitare dhe rolin si agjent i transaksione (shipping agents) janë pjesë e mbulimit nga tarifën.
- Kostot në aktivitetin e bashkimit të tregjeve duhet të identifikohen dhe të trajtohen sipas metodologjisë së ndarjes së kostove midis NEMO-ve dhe OST-ve



1.2.2 Periudha e Strukturës së Tarifave

Kjo strukture tarifash aprovohet për një periudhë maksimumi deri në 31 Maj 2029. ALPEX duhet që të raportojë pranë entit rregullator për çdo devijim (min-max) nga parashikimi i ndryshimit të kapitalit sipas kalendarit tabela nr.2.


Tabela nr.2

Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Kapitali neto në mijë lekë	250,000	217,256	164,907	68,736	60,735	98,000	146,000	207,000	250,000
Kapitali neto në mijë Euro (1 €=110 lekë)	2,273	1,975	1,499	625	552	891	1,327	1,882	2,273
Devijanca e lejuar në lekë (min-max)	N/A	N/A	N/A	N/A	30,000 ÷ 80,000	60,000 ÷ 100,000	130,000 ÷ 180,000	180,000 ÷ 220,000	230,000 ÷ 260,000

Nëse gjatë këtyre viteve kapitali neto është jashtë kufijëve të devijimit (Devijanca e lejuar) ALPEX duhet të dërgojë propozimin e ri në entet rregullatore për konfirmim ose rishikim të listës së tarifave. ALPEX mund të paraqesë për rishikim të listës së tarifave edhe në rastet e ndryshimeve legjislative, modelit të tregut apo zhvillimeve të tjera rajonale dhe europiane të proceseve integruese.

1.3 Kategoritë e pjesëmarrësve në tregjet ALPEX-it

Të ardhurat e krijuara në operacionalizimin e ALPEX parashikohen të kenë burimet nga Anëtarët e Bursës dhe Anëtarët e Klerimit dhe të cilat do të mbulojnë kostot e alokuar dhe jo alokuar si dhe do të gjenerojnë fitim për të përmbushur objektivin sipas kalendarit.



1.3.1 Anëtarët e Bursës

Anëtarët e Bursës tarifohen me tarifën fikse të tilla si: Tarifa Administrative, Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës, Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës. Anëtarët e Bursës gjithashtu do të tarifohen me Tarifën Variabël siç janë: Tarifa Variabël e Tregtimit për €/MWh, Tarifa Variabël e Klerimit për €/MWh, Tarifa e Tregtimit në Emër të Dikujt Tjetër për Urdhërporosi.

1.3.2 Anëtarët e Klerimit

Anëtarët e Klerimit tarifohen me tarifën fikse siç janë Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit, Tarifa Vjetore për Anëtarin e



Përgjithshëm të Klerimit, Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal të Klerimit dhe Tarifa Administrimit të Letër Garancisë Bankare.

ALPEX ka ndjekur një qasje që të ardhurat të vijnë më së shumti nga pjesëmarrja e Anëtarëve të Bursës në aktivitetin e tregtimit. Pra, komponenti variabël është dominues mbi atë fiks. Kjo nënkupton që pagesat që ata bëjnë kundrejt ALPEX gjatë një viti, të paktën 60% vijnë nga aktiviteti në tregtim dhe pjesa tjetër i përket tarifave fikse.

1.4 Tarifat shtesë të shërbimit

Aty ku është e mundur praktikisht që ALPEX të identifikojë se bërja e diçkaje specifike për një pjesëmarrës ose një palë tjetër jo të përfshirë në grupin 1.3.1 dhe 1.3.2, dhe ky veprim shkakton kosto të identifikueshme dhe materiale për ALPEX, ALPEX do të vazhdojë të kërkojë të vendosë tarifa për të rikuperuar kostot shtesë të shkaktuara. Kjo mund të përfshijë:

- Tarifat e abonimit për shërbimet ose raportet e kërkuara për t'u prodhuar për pjestarët jo-anëtarë të ALPEX-it.
- Tarifimi për raportet dhe shërbimet ad-hoc të zhvilluara nga ALPEX dhe të ofruara nga sistemet e tij.
- Aplikimi i një tarife shërbimi për një pjesëmarrës ose një palë tjetër i cili paguan për kërkesat që lidhen me ëorshop, trainime dhe konferenca dhe të ngjashme.



Aneksi A: Lista e Tarifave të ALPEX SHA si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për tregjet e Shqipërisë dhe Kosovës

Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Administrative	Një herë	200 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	Një herë	7,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	Një herë	5,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës	Vjetore	10,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	6,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh	Transaksion	0.070 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	Transaksion	0.020 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Tregtimit në Emër të Dikujt Tjetër	Urdhërporosi	20 €	Anëtari i Bursës
Tarifa për API Përdorues	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal të Klerimit	Mujore	100 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa e Administrimit të Letër Garancisë Bankare	Kur depozitohet	50 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa vjetore e Trajnimit	Vjetore	200 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Tarifa e Provimit	Vjetore	100 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Certifikata digjitale për përdorues	Vjetore	50 €	Anëtari i Bursës / Anëtari i Klerimit

- Për tregun e Kosovës të gjitha tarifat do të shlyen në monedhën Euro.
- Për tregun e Shqipërisë të gjitha tarifat do të shlyen në monedhën Euro për jo-rezidentet.
- Për tregun e Shqipërisë të gjitha tarifat fikse do të shlyen në monedhën Lekë.
- Mbi tarifat do të aplikohet TVSH-ja.



Aneksi B: Strukturat e tarifave të tregut të energjisë elektrike në tregjet e tjera krahasuese

Bursa energjisë Shteti	ALPEX	MEPX M.i Zi	MEMO M. e Veriut	HENEX Greqia	IBEX Bullgaria	CROPEX Kroacia	SEEPEX Serbia	BSP Slovenia
Tarifa e Anëtarësimit në bursë	7,000 €	15,000 €	5,000 €	6,000 €	6,000 €	15,000 €	15,000 €	15,000 €
Tarifa Vjetore	10,000 €	12,000 €	9,000 €	10,000 €	12,000 €	12,000 €	10,000 €	4,500 €
Tarifa e tregtimit	0.07 €/MWh	0.1 €/MWh	0.065 €/MWh	0.046 €/MWh	0.07 €/MWh	0.06 €/MWh	0.095 €/MWh	0.07 €/MWh
Tarifa e Klerimit	0.02 €/MWh	0.02 €/MWh	0.02 €/MWh	0.015 €/MWh	0.01 €/MWh	0.03 €/MWh	0.02 €/MWh	0.02 €/MWh
Tarifa e aksesit të ETSS	N/A	5,000 €	N/A	N/A	N/A	4,000 €	8,000 €	5,000 €
Tarifa e përdoruesit shtesë në ETSS	N/A	3,000 €	N/A	N/A	1,500 €	1,000 €	3,000 €	1,000 €
Tarifa e protofolit shtese	N/A	2,000 €	2,000 €	N/A	3,000 €	1,000 €	2,000 €	N/A
Tarifa për përdorim API	2,000 €	N/A	N/A	S'ka info	2,400 €	1,500 €	S'ka info	1,000 €
Tarifa Vjetore e Anëtarit të Klerimit	6,000 €	N/A	N/A	9,600 €	N/A	N/A	N/A	N/A
Tarifa e Tregtimit në Emër të Dikujt Tjetër	20 € Urdhërporsi	50 € Urdhërporsi	50 € Urdhërporsi	10 € Urdhërporsi	N/A	N/A	S'ka info	N/A
Tariffa e trajnimit	200 €	N/A	N/A	150 €	400 €	N/A	S'ka info	200 €
Tariffa e provimit	100 €	N/A	N/A	150 €	150 €	N/A	S'ka info	100 €

VENDIM

Nr. 288, datë 9.10.2023

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 13, si dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1798/8 prot., datë 5.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve

dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1798/1 prot., datë 4.9.2023, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 274, datë 19.9.2023, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës të shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.9.2023 dhe 21.9.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 29.9.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1798/6 prot., datë 22.9.2023, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës së rinovimit të licencës.



- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 8.3.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 289, datë 9.10.2023

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1,

germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 13, si dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1798/7 prot., datë 4.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1798/1 prot., datë 4.9.2023, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 275, datë 19.9.2023, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.9.2023 dhe 21.9.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 29.9.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1798/6 prot., datë 22.9.2023, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës së rinovimit të licencës.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 8.3.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 290, datë 9.10.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “ECO-ELB” SHA PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI I PËRPUNIMIT TË
MBETJEVE URBANE, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 2850 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar

me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 137/14 prot., datë 4.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ECO-ELB’ sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ECO-ELB” sh.a. është mbajtëse e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.4.2022 dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 142, datë 24.4.2023, me afat vlefshmërie deri më 27.3.2024. Më datë 27.9.2023, shoqëria ka paraqitur në ERE aplikimin për rinovimin e kësaj licence.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, ndaj aplikimi i shoqërisë është paraqitur brenda këtij afati.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “ECO-ELB” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, germa: “a”, “b” dhe “c”; si dhe nenin 16, pika 7, të rregullores.

- Shoqëria “ECO-ELB” sh.a. ka marrë në përdorim impiantin e incenerimit për të kryer aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike në mbështetje të kontratës së qirasë midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. me nr. 1027, datë 10.3.2023, duke filluar afatin 1-vjeçar nga data 27.3.2023. ERE, me vendimin e Bordit nr. 142, datë 24.4.2023, e ka rinovuar licencën e shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në mbështetje të afateve të kësaj kontrate, pra deri më datë 27.3.2024. Aktualisht shoqëria disponon një kontratë të vlefshme qiraje, në vijim vlerësojmë se vendimmarrja e ERE-s për rinovimin e licencës së shoqërisë do të mbështetet mbi informacionin/dokumentacionin që do të depozitohet nga shoqëria në lidhje me rinovimin e kësaj kontrate.

- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores dhe nuk rezulton debitor për pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.



Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kw, duke filluar nga data 28.3.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ECO-ELB” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 291, datë 9.10.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 16.11.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘IDI 2005’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘KAMIÇAN’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1860 kw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës

9.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2033/14 prot., datë 4.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 16.11.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kamiçan’, me kapacitet të instaluar 1860 kw’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 16.11.2020, të ndryshuar, vendosi të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamiçan”, me kapacitet të instaluar 1860 kw, për një afat 30-vjeçar, duke i lënë kushtin që të depozitojë në ERE brenda datës 25.10.2023, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan”.

- ERE, me shkresën me nr. 2033/10 prot., datë 22.9.2023 i kujtoi shoqërisë detyrimin e lënë në pikën 2, germa “b”, të vendimit të Bordit nr. 188/2020, që brenda datës 25.10.2023, duhet të depozitojë lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan”.

- Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2033/12 prot., datë 29.9.2023, shoqëria ka depozituar lejen e përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor me nr. serie 000128, nr. 642 prot., datë 5.7.2023, të miratuar me vendimin nr. 23, datë 29.6.2023, të Këshillit të Basenit Ujqor Seman për përdorimin e burimit ujqor për HEC “Kamiçan”, me një afat 5-vjeçar, deri më 29.6.2028.

- Me depozitimin e këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, germa “b”, të vendimit nr. 188/2020, të ndryshuar, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe, po ashtu, i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan” brenda datës 29.6.2028.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë



një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 16.11.2020, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. të depozitojë në ERE:

b) brenda datës 29.6.2028, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga HEC “Kamçan”.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë